



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

REKTOR

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A

SEKTORI JURIDIK

Nr. 1807 prot.

Tiranë, më 24.12.2021

URDHËR

Nr. 181, date 24 /12 /2021

“MBI DITËT E PUSHIMIT PËR FESTAT ZYRTARE”

Bazuar në nenin 39 të ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 06.10.2021 “ Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, kreu IV, pika 3,

URDHËROJ:

1. Me rastin e festave zyrtare “Krishtlindjet”, bazuar në VKM e sipërcituar, data 25.12.2021 shtyhet në ditë pushimi në datën 27.12.2021.
2. Me rastin e festave zyrtare të “Ndërrimit të viteve”, bazuar në VKM e sipërcituar datat 01.01.2022 dhe 02.01.2022, shtyhen në ditë pushimi në datat 03.01.2022 dhe 04.01.2022.
3. Personeli ndihmës akademik në Fakultete menaxhohet nga Dekani i Fakultetit me grafik, për ofrimin e shërbimeve në Fakultet;
4. Procesi mësimor do të rifilloj në datën 05.01.2022 dhe për zëvendësimin e ditëve të pushimit të menaxhohet nga Fakultetet.
5. Ngarkohet për komunikimin dhe zbatimin e këtij urdhëri, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Fakultetet në UART.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot Çausi

REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE

